

L I G J
Nr.9184, datë 12.2.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT, PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË BASHKËPUNIMIT "ALB/002 UJËSJELLËS-KANALIZIME, NË RAJONIN E DIBRËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për projektin e zhvillimit të bashkëpunimit "ALB/002 ujësjellës-kanalizime, në rajonin e Dibrës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4161, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE BILATERALE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË BASHKËPUNIMIT "ALB/002:UJËSJELLËS-KANALIZIME NË QARKUN E DIBRËS"

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut, përfaqësuar nga Ministria e Bashkëpunimit dhe e Veprimit Humanitar,

duke konsideruar dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e mira ekzistuese ndërmjet Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Republikës së Shqipërisë,
ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo Marrëveshje përcakton kushtet dhe procedurat për asistencën e Dukatit të Madh të Luksemburgut, si dhe bashkëpunimin për zbatimin e projektit të zhvillimit "ALB/002: ujësjellës-kanalizime në rajonin e Dibrës nëpërmjet formës së grantit.

Projekti më tej është detajuar në dokumentet e projektit të qershorit 2002 dhe miratuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

2. Qëllimi i projektit është ofrimi i asistencës në procesin e decentralizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në zonat e projektit.

3. Objektivat e projektit janë:

i) Pajisja e komunave të Maqellarës dhe Shupenzës me një sistem të ri ujësjellësi, së bashku me një strukturë të re menaxhimi të ujësjellësit dhe ndërtimi për komunën e Maqellarës i një sistemi të

ri kanalizimesh.

ii) Të ofrojë asistencë teknike për komunën e Luznit për përcaktimin e prioriteteve, lidhur me identifikimin e projekteve në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve.

Detaje të projektit gjenden në dokumentin bashkëngjitur projektit, që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Bashkëpunimi, përfaqësimi, administrimi

1. Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimi dhe objektivat e projektit të përmbushen me sukses.

2. Për çështjet lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit do të jetë organi kompetent për të përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut cakton Lux-Development si agjencinë e saj për zbatimin e projektit.

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve duhet të mbështesë dhe të ndjekë zbatimin e projektit.

Neni 3

Kontributet e Dukatit të Madh të Luksemburgut

Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut angazhohet nga ana e saj për të bërë të disponueshëm kontributin financiar (grant) jo më shumë se 4 365 000 (katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro, për një periudhë prej 30 muajsh, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i projektit të përmendur në nenin 1.

Neni 4

Kontributet dhe detyrimet e Qeverisë së Shqipërisë

Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të lehtësuar zbatimin me sukses të projektit dhe:

1. duhet të ofrojë lehtësira, shërbime dhe rregullime siç janë referuar në dokumentin e projektit;

2. duhet të ofrojë personel të mjaftueshëm lokal të kualifikuar, burime financiare dhe burime të tjera, të cilat mund të kërkojnë nën apo mbi shumën e grantit për zbatimin me sukses të projektit;

3. duhet të lirojë nga çdo lloj detyrimi doganor, taksë shitjesh dhe taksa të tjera mbi pajisjet, materialet, livrimet dhe shërbimet (përveç automjeteve) të financuara nga granti dhe të importuara në Shqipëri si përfitim për projektin;

4. duhet të lirojë nga çdo lloj detyrimi doganor, taksë shitje dhe taksa të tjera mbi automjetet të financuara nga granti dhe të importuara në Shqipëri si përfitim për projektin pas ratifikimit në Kuvend të kësaj Marrëveshjeje nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

5. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër, duke e planifikuar në buxhetin e shtetit për ministrinë, pagesën e TVSh-së për të gjitha pajisjet, materialet, livrimet dhe shërbimet e nevojshme për zbatimin e projektit;

6. duhet të paguajë ose të kërkojë përjashtimin nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat ose taksa të tjera personale në bashki, në nivel rajonal dhe/ose në nivel republike për personelin e huaj të Lux-Development, duke i planifikuar ato në buxhetin e shtetit për ministrinë vetëm për zbatimin e projektit;

7. duhet të ofrojë të gjitha licencat e nevojshme të importit dhe lejet për shkëmbime të huaja, lejet dhe vizat e nevojshme që mund të kërkojnë në lidhje me zbatimin e projektit;

8. duhet të sigurojë mbrojtjen e personelit në objektin e zbatimit të projektit dhe gjatë udhëtimeve të shërbimeve të punës;

9. duhet të informojë menjëherë Qeverinë e Dukatit të Madh të Luksemburgut për ndonjë kusht, i cili ndërhyr apo rrezikon të ndërhyjë në zbatimin me sukses të projektit;

10. duhet të asistojë përfaqësuesit e Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për marrjen

e lejeve për të vizituar ndonjë zonë të projektit për qëllime lidhur me këtë Marrëveshje dhe të kontrollojë të dhëna të rëndësishme, mallra dhe dokumente.

Neni 5
Prokurimi

Të gjitha prokurimet duhet të kryhen në përputhje me parimet e përgjithshme të pranueshme dhe praktikat e prokurimit të mallrave dhe në përputhje me procedurat e prokurimit të Lux-Development, siç është përshkruar në aneksin H të dokumentit të projektit.

Neni 6
Pagesat

Pagesat do të kryhen direkt nga Lux-Development në bazë të marrjes së faturave të certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe të miratuara nga Lux-Development.

Neni 7
Të drejtat

Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut rezervon të drejtën të ndërpresë disbursimet në çdo kohë, në rast se projekti zhvillohet në mënyrë të pafavorshme lidhur me qëllimin dhe objektivat.

Neni 8
Mosmarrëveshjet, hyrja në fuqi, mbarimi

1. Çdo mosmarrëveshje që lind lidhur me zbatimin ose interpretimin e Marrëveshjes prezente duhet të zgjidhet në mënyrë miqësore me anë të negociatave të kanaleve diplomatike. Në rast se dështohet arritja e një marrëveshjeje, atëherë do t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

2.a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur do të nënshkruhet nga të dyja palët, përveç klauzolës së përmendur në nenin 4(4), e cila do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Fakti që klauzola e përmendur në nenin IV (4) do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk do të bllokojë hyrjen në fuqi të pjesës tjetër të Marrëveshjes në datën kur ajo nënshkruhet nga të dyja palët.

b) Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi deri në përfundimin e projektit ose deri në mbarimin e fondeve të vëna në dispozicion nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Të nënshkruarit, duke vepruar si përfaqësues në emër të qeverive të tyre respektive, kanë nënshkruar Marrëveshjen prezente në dy origjinale në gjuhën angleze.